

URDHËR
Nr. 437, datë 6.7.2018

**PËR LICENCIMIN E SHOQATËS GRAMM-A SI AGJENCI E ADMINISTRIMIT
KOLEKTIV NË FUSHËN E MBAJTËSVE TË TË DREJTAVE TË PRODHUESVE TË
FONOGRAMEVE DHE VIDEOGRAMEVE**

Në mbështetje të pikës 4, nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 134, 135, 157 dhe 158, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”; udhëzimit nr. 5166, datë 20.10.2016, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të tjera shitesë në sqarim të kriterëve të parashikuara në nenin 133, si dhe përcaktimin e kushteve dhe procedurës së marrjes së licencës ose ripërtëritjen e saj”, në bazë të nenit 134, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”; si dhe kërkesës së shoqatës GRAMM-A për pajisje me licencë nr. 3658 prot., datë 28.5.2018, të urdhrit të ministrit të Kulturës nr. 205, datë 4.4.2018, “Për ngritjen e grupit të punës, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për licencim/ripërtëritjen e tyre në fushat e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në administrimin kolektiv, në përputhje me kriteret dhe procedurat e parashikuara në ligjin 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, ndryshuar me urdhrin nr. 228, datë 17.4.2018, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 205, datë 4.4.2018”, si dhe legjislacionin në fuqi “Për organizatat jofitimprurëse”,

URDHËROJ:

1. Licencimin e shoqatës GRAMM-A si agjenci e administrimit kolektiv në fushën e mbajtësve të të drejtave të prodhuesve të fonogrameve dhe videogrameve.
2. Afati i licencës është tre (3) vjet nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
3. Pas botimit në Fletoren Zyrtare të urdhrit të ministrit të Kulturës për ripërtëritjen e licencës, agjencia është e detyruar të kryejë pagesën në vlerën prej 300.000 lekësh, e parashikuar në vendimin nr. 33, datë 18.1.2017, “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit”.
4. Ngarkohet Drejtoria e së Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I KULTURËS
Mirela Kumbaro Furxhi